



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE PROFESIONALE "DEMIR PROGRI" KORÇË

Nr. 2 prot.

Data 05.01.2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional" Ofruesi publik i AFP-së shkolla e mesme teknike profesionale "Demir Progri" Korçë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- I Mësimdhënës i praktikës profesionale në drejtimin Mekanikë, me kohë të plotë.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të pakën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të ofruesit të AFP-së për të cilin po aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën , në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në)
- c) Kartën e identitetit
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- g) Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurivë në teknologjinë e informacionit.
- h) Vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

- j) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marre masë disiplinore në fuqi
k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës ...18.01.2022

DREJTORE

Pranvera Zhurka

